



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 35/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër disa personave, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHEN si të pabazuara ankesat me numër të lendes A nr. 35, A nr. 36, dhe A nr. 49 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar dy ankesa me datë 09.01.2011 dhe një ankesë me datë 10.01.2011, nga subjekti politik LVV në të cilat theksohet se:

A nr. 35- Ne këtë ankesë theksohet se me datën 09.01.2011 rreth orës 17:55 është sulmuar vëzhguesi i LVV Frasher Krasniqi nga 3 anëtarë të PDK-se. Ngjarja ka ndodhur ne fshatin Prekaz i Epërm komuna e Skenderajit. Po ashtu personat të cilët e kanë sulmuar vëzhguesin e LVV-se kanë dashur t'ia marrin telefonin duke i thenë “se po flete shume ne telefon”.

A nr. 36- Me datën 09.01.2011 ne komunën e Skenderajit ne fshatin Prekaz i Epërm, nje person me emrin Remzi Meha ne oren 15:05 i drejtohet me agresivitet vëzhguesit të LVV-se duke përdorur fjale shume te ashpra si, “ti s’ke te drejtë të lëvizësh”. Sipas parashtruesit të ankesës ky kërcenim ka vazhduar gjate gjithë kohës.

A nr. 49 është plotësim i A nr. 35 Prekaz i Epërm, Skenderaj, QV 2105b. Parashtruesi thekson se “personi i cili e ka kërcenuar verbalisht dhe e ka sulmuar fizikisht vëzhguesin tonë është Haxhi Bejta se bashku me një person tjetër të panjohur”. Sipas parashtruesit të ankesës, asnjë veprim nuk është marrë për ta ndaluar këtë sulm nga ana e personave zyrtar dhe nga KKZ-ja. Shtabi zgjedhor e ka denoncuar rastin pranë organeve të rendit dhe si provë është rasti i hapur ne polici me nr 2011-BF 021

Ne raportin e policisë me Nr. reference 2011-BF-021, te dates 09.01.2011 te lëshuar nga oficeri policor Afrim Beka PK#2390 theksohet se me datën 09.01.2011 rreth ores 18:00 nga baza jemi informuar se ne fshatin Prekaz i Epërm, pikërisht ne qendrën e votimit, shkolla fillore Azem Bejta vëzhguesi i LVV-se Frashër Krasniqi eshte sulmuar nga nje person. Pas pranimit te kesaj informate oficeri Afrim Beka se bashku me policin patrullues Bedri Zabeli, janë nisur për ne vendin e ngjarjes. Ne vendin e ngjarjes kemi arritur rreth orës 18:30, ku janë kontaktuar edhe policët te cilet ishin ne sigurimin e vendvotimit. Sipas oficerit policor Afrim Beka, Frashër Krasniqin është kontaktuar, dhe ka informuar se rreth orës 17:45 dy persona e kishin sulmuar ku njeri nga ata e ka identifikuar si Hazhi Bejta. Sipas raportit policor në lidhje me rastin e

paraqitur është informuar baza dhe të njëjtit në ndihmë kanë dërguar edhe njësitin e hetimeve në përbërje të Masar Seven dhe Hazir Haziri, të cilët kanë kontaktuar ankuesin dhe njëherit nga udheheqsit e operacionit kanë udhëzuar që ankuesi të shkojë në stacionin policor për të intervistuar rreth ngjarjes. Pas hetimit dhe kompletimit të rastit ankuesi është liruar.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) dhe neni 6 paragrafi 3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim- marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë.

PZAP-i vlerësoi se kemi të bëjmë me rastin e njëjtë dhe pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesat janë te pabazuara.

Për të vërtetuar shkeljen e pretenduar nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i ka kërkuar hetim nga Policia e Kosovës. Në bazë të raportit të policisë me nr 2011-BF-021 të datës 09.01.2011 si dhe nga shkresat e lëndës të paraqitura deri me tani, PZAP gjykon se nuk janë ofruar prova të mjaftueshme dhe si rrjedhim është në pamundësi të vërtetimit të faktit të pretenduar. Njëkohësisht PZAP vlerëson se në përputhje me nenin 118.4 mund të rishikojë cilindo nga vendimet e mara pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 35/2011 më datën 13.01.2011.

